



Pranim / Dorezuar Priljena / Predato Received / Delivery	10.05.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org. / Unit	SKPM/SHK	2684/2022	Sasia Kolicina Quantity
			112



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

### KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.414/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtar dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.414/2022 e datës 22.04.2022 e parashtruar nga ankuesja kundër Vendimit me numër 0440 të datës 19.04.2022 të Drejtorit të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 10.05.2022, mori këtë:

#### V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar me ankesën me numër A.nr.414/2022 të datës 22.04.2022 e parashtruar nga ankuesja.

#### A r s y e t i m

Ankuesja me datë 22.04.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 2325/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendim ankimor kundër vendimit me numër 0440 të datës 19.04.2022 të Drejtorit të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

*Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova:* Ankesa e ankueses e datës 22.04.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me numër 0440 i datës 19.04.2022 i Zv. Drejtorit të Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës; Akt emërimi i datës 19.04.2022; Vendimi A.Nr.114/2022 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe kërkesa e ankueses e datës 26.04.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.



Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruar nga palët, konstaton se është plotësuar kërkesa ligjore për përfundim të procedimit administrativ e filluar me ankesën me numër A.nr.414/2022 të datës 22.04.2022 e parashtruar nga ankuesja

*sepse:*

Bazuar në shqyrtimin e shkresave të lëndës Kolegji, gjenë së ankuesja me datë 22.04.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 2325/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa më datë 26.04.2022 ka parashtruar kërkesë me numër protokollit 2404/2022 për tërheqje të ankesës me numër të protokollit 2325/2022 të datës 22.04.2022 me arsyetim se: *"kërkoj nga ana e juaj që ankesa ime e dorëzuar tek ju me datën 22.04.2022, të mos trajtohet tutje nga organi i juaj dhe si i tillë të trajtohet si e tërhequr në mënyrë të vullnetshme nga ana ime"*.

Në bazë të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përkatësisht nenit 103 paragrafi 1 me të cilin është përcaktuar se: *"Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërhequr atë"*, andaj duke u nisur nga veprimi administrativ i ankueses për tërheqjen e ankesës së parashtruar në Këshill, Kolegji konstaton që të përfundoj procedimi administrativ i filluar me ankesën me numër A.nr.414/2022 e datës 22.04.2022 e parashtruar nga ankuesja

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 103 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda me numër A.nr.414/2022**

**Valentina Kacandolli Bekteshi**



**Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional**

**Malsore GASHI BAJRAKTARI**



**Kryetare e Kolegjit**

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

